



Forumi Musliman i Shqipërisë

Muslim Forum of Albania

Prot. Nr. 116

Dt. 08.01.2011

Drejtuar:

Ministrit të Arsimit prof. Dr. Myqerem Tafaj

Lënda: Vërejtje mbi Projektligjin për Arsimin Parauniversitar, paraqitur nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës

Për dijëni:

Shkëlqesisë së tij Prof. Dr. Sali Berisha, kryeministër

Shkëlqesisë së tij z. Aleksandër Arvizu ambasador i SHBA

Shkëlqesisë së tij z. Eugen Volfard, Përfaqësues i OSBE – ODIHR

Prezencës së Bashkimit Evropian- Tiranë

z. Rasim Hasanaj, Kryetar i Komitetit Shtetëror për Kultet

I nderuar zotëri,

Kemi ndjekur me shumë vëmendje dhe studiuar në bashkëpunim me juristë pranë Forumin Musliman të Shqipërisë projektligjin për Arsimin Parauniversitar të përgatitur nga MASH, si dhe shqetësimet e paraqitura nga grupet e interesit në lidhje me këtë projekt-ligj. Edhe ne i bashkohemi atyre, duke ju paraqitur si më poshtë vërejtjet tona për këtë projekt-ligj,

në kuadër të përmirësimit të tij për të çuar më tej dhe për të rritur cilësinë e arsimit të fëmijëve tanë. Këtu kemi pasur parasysh edhe parimin e njërit prej shtetarëve shqiptarë dhe rilindës njëkohësisht, Luigj Gurakuqi, i cili thoshte: “Feja e lirë në shtet të lirë”. Për këtë dhe shumë arsye të tjera po ju paraqesim vërejtjet tona të mëposhtme:

Shamia apo Mbulesa e Kokës në Perëndim

Amendamenti i Parë i Kushtetutës së SH.B.A-së deklaron: “Kongresi nuk do të bëjë asnjë ligj që ndalon ushtrimin e lirë të fesë...” Amendamenti i 14-të garanton mbrojtje të barabartë të të gjithë qytetarëve. Po ashtu çdo formë e diskriminimit për sa i përket ushtrimit të praktikave të besimit është e ndaluar nga “Civil Rights Act”. (1964, 88th Congress, H.R. 7152)

Në Sh.B.A. hapësirat publike nuk konsiderohen totalisht të lira nga religjioni, por rregullat e përgjithshme dhe ligjet sanksionojnë që hapësirat publike duhet të jenë të hapura për forma të ndryshme të besimit. Roli i qeverisë amerikane nuk është të forcojë sekularizmin, por të përshtasë shprehjen e besimeve në mënyrë neutrale. (*Unsecular America, Christian Century, Vol. 121, No. 4, 24 February 2004, p. 5*).

Në vitin 1995, Presidenti amerikan i asaj kohe lëshoi një udhëzim në të cilin thuhej: “Në asnjë vend në Amendamentin e Parë nuk kërkohet që shprehja e besimit të lihet prapa dyerve të shkollave... Studentët mund të shprehin mesazhe fetare në veshje ashtu siç në çdo kontekst. Si përfundim shkollat nuk mund të ndalojnë praktikën fetare si pjesë e identitetit të studentëve”. (*Christian Century, 24 February 2004*).

Në Korrik të 2001, Shërbimi Kundra Zjarrit dhe Shpëtimit në Montgomery Maryland ia lejoi një oficerëve muslimane të mbante shaminë e saj gjatë detyrës, e cila do të duhej të pajisej me helmetë në rast të ndërhyrjeve kundra zjarrit. (“*Maryland Firefighter Wins Right to Islamic Headscarf, US Newswire, 12 July 2001. Morgan (2003), p. 37*).

Në Shkurt të 1995, “*Commission des droits de la personne et des droits de la jeunesse*” i Quebec-ut në Kanada konkludoi që shkollat publike janë të “detyruara” të pranojnë nxënëset muslimane me shami në kokë, për arsye se kjo nuk përbën rrezik publik. Komisioni vendosi se ndalimi i shamisë dhuron, si lirinë e besimit edhe lirinë e arsimit, dhe është në kundërshtim me Kartën e Quebec-ut. Komisioni gjithashtu argumentoi asokohe se: “Edhe pse mund të ketë raste të shkëputura, ku një vajzë mund të jetë e detyruar forcërisht të vërë shaminë, ndalimi absolut i saj (shamisë) do të përbente një “fyerje” për pavarësinë e femrës muslimane. Institucionet sociale duhet të luajnë një rol kyç në integrimin social dhe jo të marginalizojnë individët duke i përjashtuar nga edukimi publik.” (*Looking Beyond the Trees to the Forest, Commission des droits de la personne et des droits de la jeunesse du Québec, 15 June 2005*).

Një gjykatës në Kanada lëshoi një protokoll veshjeje për pjesëmarrësit në Sallën e Gjyqit, ku thuhej që koka duhet të jetë e zbuluar përveç rasteve "...kur kjo është e njohur dhe e miratuar fetarisht dhe vetëm atëherë kur mbulesa e kokës është një "nen feje" e pretenduar nga ai komunitet". [2000] F.C.J. No. 268 (F.C.A.).

Mbretëresha e Anglisë është kreu i Kishës Anglikane dhe i Qeverisë njëkohësisht. Në përgjithësi Gjykatat Britanike kanë vendosur për pjesëmarrjen e religjioneve në sferat publike, duke argumentuar se nuk ka pengesë për funksionimin e duhur të institucioneve. (*Stéphane Bernatchez and Guy Bourgeault, "La prise en compte de la diversité culturelle et religieuse à l'école publique et l'«obligation d'accommodement», Canadian Ethnic Studies, Vol. 31, No. 1, 1999, p. 167.*)

Shamitë muslimane dhe turban-ët Sikh kanë qenë tradicionalisht të lejuara në klasat e shkollave britanike. (*Grande-Bretagne: Oui au foulard islamique, La Presse, 5 March 2004, p. A13.*)

Në Korrik 2007, Gjykata e Lartë në Angli mori vendimin për të ndaluar një studente që mbante një unazë të shtrenjtë, duke u bazuar në ndalimin e bizhuterive në shkolla. Gjykata argumentoi se : "...unaza nuk ishte një kërkesë e besimit Kristian dhe ndalimi i saj nuk dhunonte të drejtat e njeriut". (*International Religious Freedom Report 2007: United Kingdom*)

Policet, oficeret, ushtaraket, motoçiklistet dhe punëtorët e ndërtimit kanë qenë tradicionalisht të lejuara të mbajnë mbulesa koke në Angli. (*La Presse, 5 March 2004.*)

Në Danimarkë specifikisht si mësuesit dhe nxënësit janë të lejuar të mbajnë mbulesa koke në klasat e shkollave. (*Nielson (1995), p. 76; "To Ban or not to Ban," Economist, Vol. 369 (8347), 25 October 2003, p. 46.*) Kushtetuta e vendit mbron lirinë e besimit po ashtu edhe lirinë e simboleve në sferën publike.

Në Itali shamitë muslimane janë të lejuara në ambientet e shkollave, po ashtu edhe në zyrat publike me arsyetimin se ato nuk përbëjnë kërcënim për sigurinë publike. (*Dominique Le Tourneau, "La laïcité à l'épreuve de l'Islam : le cas du port du 'foulard' islamique» dans l'école publique en France," Revue générale de droit, Vol. 28, 1997, p. 303.*) Italia edhe pse një vend me lidhje të forta me Kishën Katolike ka dhënë hapësirat e veta në sferën publike për religjionet e tjera.

Çështja e shamisë muslimane ka qenë pjesë e një debati të gjerë në Hollandë herët në vitet 1985. Ky debat filloi kur një autoritet lokal në Hollandë e ndaloi një vajzë muslimane të hynte me shami në ambientet e shkollës. Duke iu përgjigjur ankesave të prindërve Parlamenti hollandez anuloi ndalesën dhe la të lirë vajzën të arsimohej me shami. (*W. A. R. Shadid and P. S.*

van Koningsveld, Religious Freedom and the Position of Islam in Western Europe: Opportunities and Obstacles in the Acquisition of Equal Rights, Kok Pharos Publishing House, Amsterdam, 1995, p. 87.)

Në vitin 1999, ETC (Komisioni për Trajtimin e Barabartë) në Amsterdam vendosi në favor të një mësueseje muslimane. Komisioni argumentoi se liria e besimit ishte e mbrojtuar kushtetueshmërisht dhe se ndalimi i shamisë ishte një diskriminim direkt sepse për gratë muslimane "hijab" (shamia) është detyrim që rrjedh nga besimi Islam. (*Saharso (2003), pp. 10-13; Economist, 25 October 2003, p. 46; "En Europe peu de tentation de légiférer," Le Progrès, 2 February 2004.*)

Në Gjermani në Shtator të 2003 Gjykata e Lartë lëshoi një vendim në të cilin thuhej se mësueset muslimane janë të lejuara të mbajnë shaminë e kokës, sepse kjo nuk ndërhyr dhe nuk dëmton vlerat e Kushtetutës Gjermane. (*International Religious Freedom Report 2007: Germany.*) Ndërsa për nxënëset muslimane liria është e sanksionuar me kohë.

Në Belgjikë çështja e parë për mbulesën e vajzave muslimane me shami u ngrit herët në vitin 1989 bazuar në ndalesën që disa shkolla të Brukselit bënë për këto vajza. Pas një viti Gjykata e Apelit në Bruksel anuloi ndalesën që shkollat i kishin bërë shamive në klasa duke u bazuar në Ligjin Belg të Arsimit të vitit 1959 duke e lidhur këtë me qëndrimin neutral që sistemi shkollor duhet të mbajë në raport me besimet. Më vonë një vendim tjetër i qeverisë belge saktësoi se: "...shamitë muslimane nuk bien në kundërshtim me parimet e neutralitetit dhe janë të veshura për qëllime besimi dhe nuk përbëjnë provokim apo kërcënim publik.". (*International Religious Freedom Report 2007: Belgium. Shadid and Koningsveld (1995), pp. 88 and 92; Le Tourneau (1997), p. 302.*)

Interesi publik

Ministri i Arsimit dhe i Shkencës shprehet mediatikisht se qëllimi i nenit 36 pika 4 për ndalimin e ekspozimit të të ashtuquajturave simboleve fetare bëhet për "interesin publik". Besojmë se ministri i referohet nenit 17 të Kushtetutës ku përcaktohet privimi i të drejtave për "interesa publike dhe në mbrojtje të të drejtave të të tjerëve".

Është e qartë se ky nen kushtetues bën fjalë për privimin e të drejtës kushtetuese të individit për interesa më të mëdha publike siç ndodh në rastin e pronave, të cilat mund të shpronësohen për punë publike apo "interesa publike". Por ky privim ka menjëherë zgjidhjen kushtetuese që është kompensimi.

Siç e ilustruam më sipër në Perëndim, por edhe në legjislacionin shqiptar nuk haset kund që e drejta e ushtrimit të fesë të përbëjë dëmtim të interesit publik, apo cënim të të drejtave të të tjerëve.

Duam të theksojmë që familja e ka obligim parësor edukimin e fëmijës, përfshi këtu edhe edukimin e tij fetar, rol i cili nuk duhet t'i cenohet në asnjë mënyrë. Është e drejtë e fëmijës që në konsultim me familjen e tij të vendosë praktikimin apo jo të fesë; kjo e drejtë nuk duhet t'i mohohet nga shkolla apo institucione të tjera shtetërore. Nëse projekt-ligji kthehet në ligj në këtë format, atëhere ai i shkakton individëve apo grupit të interesit "vajza me shami" një privim të të drejtave kushtetuese për arsim dhe për ushtrim të lirisë së besimi. Po ashtu bie në kundërshtim me ligjin Antidiskriminim. Ky dëm që mund t'u shkaktohet këtyre besimtareve çfarë dëmshpërblimi ka si kundërpeshë? Kushtetueshmërisht shteti duhet të kujdeset për taksapaguesit e vet që t'i garantojë të drejtat e tyre dhe kompensime në rast të privimit të këtyre të drejtave. Ne pyesim, cili është dëmshpërblimi më i mirë për arsimimin përveçse arsimimit?

Problemet e Projekt Ligjit:

Kontradiktat me Ligjin Kundër Diskriminimit

Që në nenin 1, Ligji Kundër Diskriminimit, ndalon çdo lloj diskriminimi, qoftë ky i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, që bëhet për shkaqe të ndryshme, ndër të tjera edhe fetare. Në nenin 3 të tij ka një sërë përkufizimesh të detajuara për format e diskriminimit, si ato të drejtpërdrejta, të tërthorta ashtu edhe rastet kur ai përdoret në formën e viktimizimit. Ky ligj ka një nen të plotë, i cili i kushtohet mbrojtjes ndaj diskriminimit për çështje fetare.

Ka një kontradiktë juridike midis nenit 10 të Ligjit Kundër Diskriminimit dhe nenit 36 pika 4 të projektligjit për arsimin parauniversitar. Në fakt, projektligji është kujdesur që të ketë një nen specifik (neni 6) kundër diskriminimit të nxënësve për shkaqe edhe fetare. Pra, ky projektligj realisht nuk krijon përplasje në këtë aspekt. Duhet pasur parasysh se neni 36 është një dispozitë e karakterit administrativ, pasi është i renditur nën Kapitullin III, i cili ka të bëjë më mënyrën e funksionimit të sistemit parauniversitar. Sipas parimeve themelore të teknikës legjislative, neni dhe çdo paragraf i tij duhet të jenë në funksion dhe në një rrjedhë logjike me qëllimin e Kreut përkatës të ligjit.

Në këtë aspekt, duke qenë se në këtë Kre (Kreu III) flitet për formën administrative (funksionimin), kuptimi i nenit 36 pika 4 ka të bëjë me ndalimin e vendosjes në ambientet e institucioneve arsimore të simboleve fetare, siç mund të jetë kryqi apo edhe gjysmëhëna. Ky nen nuk mund të ketë lidhje me paraqitjen e jashtme të nxënësve, qoftë ajo mbulesa e kokës (e

përdorur si nga muslimanet dhe të krishterat) apo mbajtja e kryqit publikisht. Një interpretim i kundërt do ta bënte këtë pikë të nenit 36 kontradiktore, jo vetëm me nenin 6 të tij, apo edhe nenin 10 të Ligjit Kundër Diskriminimit, por mbi të gjitha me nenet 18 dhe 24 të Kushtetutës. Kjo do ta bënte këtë nen automatikisht antikushtetues dhe si rrjedhim nul. Por prononcimet Tuaja publike dhe të paqarta z. Ministër në emisionin e datës 22/12/2010 në emisionin e ALSAT TV, linin të nënkuptohej se interpretimi i tij, qoftë personalisht apo si përfaqësues i institucionit, ishte se kuptimi i këtij neni e përfshinte paraqitjen e jashtme të nxënësve. Pra, shqetësimet e ngritura në media apo edhe nga analistë të shumtë ishin të drejta.

Paqartësitë dhe konfuzioni juridik

Pika 4 e nenit 36 të këtij projektligji shkel edhe të drejtën e punësimit të mësuesve praktikantë të feve të ndryshme dhe që kanë një paraqitje/luk fetar. Pyetja që ngrihet në këtë kontekst është, a do të konsiderohet 'ekspozim i simbolit fetar' një kryq që mbahet i varur në qafë publikisht nga një mësues/e gjatë orës së mësimit?

Nga ana tjetër, është e paqartë se çfarë ka parasysh ligjvënësi me termin simbol fetar. Pasi, p.sh., mbulesa e kokës për femrat muslimane apo edhe të krishtera në rastin e murgeshave, sipas doktrinave përkatëse fetare, nuk konsiderohet simbol, por pjesë e domosdoshme e veshjes femërore. Pra, nuk bëhet fjalë për ndonjë emblemë identifikuese, propagandistike, por thjesht për një mbulim të mëtejshëm të trupit, sipas një pikëpamjeje më konservatore për privatësinë dhe intimen. Po të konsiderohej Shamia (Mbulesa e Kokës) simbol do të krijohet një konfuzion: A do të konsiderohet ajo simbol musliman, apo i fesë së krishterë?

Në rast se neni 36 pika 4 ka parasysh këtë kategori mësuesish, atëherë kjo do të krijonte padyshim përplasje me nenin 12 dhe 13 të Ligjit kundër Diskriminimit. Këto nene mbrojnë çdo individ, i cili diskriminohet për shkaqe fetare në lidhje me punësimin. Nga ky këndvështrim, neni 36 pika 4 mund të krijonte përplasje edhe me nenin 49 të Kushtetutës, i cili mbron të drejtën e çdo shtetasi për të zgjedhur profesionin dhe vendin e punës që ai kërkon. Kjo, duke respektuar të drejtat e tij fetare të përcaktuara nga neni 24 i Kushtetutës. Është pikërisht kjo pikëpamje juridike që e bën pikën 4 të nenit 36 të kontestueshme. Në këtë kuptim ky nen e bën këtë projekt-ligj konfliktual me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi.

Gjithashtu referuar Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i cili bazohet në nenin 116 të Kushtetutës së RSH, i cili e konsideron Kodin Civil si një ligj i miratuar me një shumicë të cilësuar votash (3/5 = 84 vota të deputetëve) konstatojmë se koncepti i zotësisë juridike të kufizuar për të vepruar fillon kur personi fizik mbush moshën e pubertetit. Referuar literaturës juridike dhe Kodit Civil të RSH, si moshë për fitimin e zotësisë së kufizuar për të vepruar është moshë 14 vjeç. Kjo do të thotë që Legjislacioni jonë i jep disa të drejta si dhe disa detyrime personit, i cili

ka arritur këtë moshë. Si e tillë duke qenë se Kodi Civil është një akt-juridik i një rëndësie më të lartë krahasuar me projekt-ligjin në fjalë kërkohet si një imperativ *sine qua non* që projektligji t'i referohet (dispozitë referuese neneve të Kodit Civil), të cilat flasin mbi fitimin e këtyre të drejtave dhe posedimin e këtyre detyrimeve ndaj të tretëve. Projektligji në fjalë dhe rregullorja e brendshme e shkollave duhet të jenë në sinkron me Kodin Civil, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (neni 9 i KEDNJ), dhe në Kartën Evropiane Sociale (KES), si dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës. Arrijmë në konkluzionin se mbajtja e Shamisë (Mbulesa e Kokës dhe jo e fytyrës) duhet patjetër të lejohet në lidhje me ato vajza, të cilat e kanë vendosur me dëshirën dhe me vullnetin e tyre të ligjshëm dhe të pavesuar (jo në kushtet e kanosjes, mashtrimit, detyrimit, lajthitjes). Projekt-ligji në fjalë duhet ta përfshijë një gjë të tillë.

p.s. Kjo gjë gjën pasqyrim edhe në legjislacionet e vendeve të Bashkimit Evropian (Italia, Gjermania, Norvegjia, Suedia, Finlanda, etj.), si dhe të atyre vendeve që kanë marrë statusin e vendit kandidat, si R. e Maqedonisë, e Malit të Zi dhe e Kroacisë.

Sugjerimet:

1-Në nenin 3, i cili ka të bëjë me përkufizimet, të bëhet përkufizimi i termave '**indoktrinim fetar**' dhe '**simbole fetare**'. Gjithashtu të bëhet i qartë dallimi me praktikat fetare. Të përkufizohet në mënyrë më të plotë termi "institucion arsimor". Të sqarohet gjithashtu, nëse ky përkufizim përfshin vetëm ambientet fizike apo edhe personat që ushtrojnë aktivitete në të, përfshirë këtu nxënësit dhe mësuesit. Po në këtë drejtim të rihartohet pika 4 e nenit 36 duke sqaruar nëse bëhet fjalë për shfaqje në ambientet e institucioneve arsimore apo edhe për shfaqje nga ana e nxënësve dhe mësuesve, duke përjashtuar kategorinë e vajzave me shami mbi moshën 14 vjeç në akordancë me Kodin Penal.

2-Të hartohet një nen i veçantë në lidhje me ndalimin e ekspozimit të simboleve fetare. Po në këtë nen të bëhet një përcaktim i qartë, në pika të veçanta, për rastet që ka parasysh ky nen.

3- Ky projektligj mund të shoqërohet edhe me një material/guidë shpjeguese për çdo nen në atë se çfarë ka parasysh legjislatori. Zakonisht këto guida nuk kanë karakter detyrues, por ndihmojnë në një kuptim më të qartë dhe zbatim të ligjit. Kjo mund të publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përkatëse, për konsultim publik, dhe për të shmangur çdo keqkuptim nga institucionet dhe individët që preken nga ky ligj.

Konkluzion

Ky projekt-ligj, ashtu siç rëndom ndodh tek ne me ligjet, të cilat transformohen në një përzierje të kulturave juridike perëndimore, ka marrë për çështje të ndryshme referenca nga vende të

ndryshme. Përsa i përket nenit 36 pika 4 më shumë se çdo vend tjetër është përzgjedhur modeli francez.

Çuditërisht një vend si i yni, i cili ka një trashëgimi kulturore muslimane, nuk ka probleme të imigrantëve dhe integritit të tyre në vend, nuk e konsideron shqiptarizmin si proces asimilimi ndaj pakicave të tjera, përkundrazi, ka një kulturë tolerance fetare burimore dhe të shkëlqyeshme, merr një shuplakë laike tip "laïcité" duke shkaktuar precedentin e mohimit me ligj të të drejtave universale. Jo vetëm kaq, por ky projekt-ligj u lejon shkollave të veçanta të hartojnë rregullore, të cilat mund të dalin mbi kushtetutën, pra të kemi "Kushtetutë shkollash dhe Rregullore Shqipërie".

Procesi i mësimdhënies apo i teksteve shkollore është proces laik i miratuar. Nuk ka asnjë dokument ligjor ose jo, që thotë se procesi i mësim-marrjes apo përrhithjes së dijes duhet të jetë laik. Sepse do të ishte absurde dhe në të njëjtën kohë imponuese duke shkelur bazën e demokracisë. Për rrjedhojë përrhithja e dijes bëhet lirshëm nga nevoja për laicizëm. Ajo është një e drejtë individuale dhe si e tillë gëzon të gjitha parametrat e lirisë së individit.

Nën pretekstin e "*interesi publik*" kjo kategori vajzash mund të privohet nga të drejta të tjera kushtetuese (gjithmonë pa kompensim), si e drejta për të pasur shërbim shëndetësor, shërbim të gjendjes civile, shërbime të tjera administrativo-qytetare të domosdoshme për një anëtar komuniteti.

E kaluara komuniste dhe imponimi me forcë i saj nuk është shuar ende nga kujtesa jonë dhe problemi i Mbulesës Muslimane nuk bëri gjë tjetër veçse na e solli edhe një herë në vëmendje ato vite të hidhura, që ne të gjithë i kemi përjetuar gjithsecili sipas mënyrës së vet. Dhe sot kur problemi i Shamisë apo i Mbulesës nuk na bën gjë tjetër veçse të na kujtojë edhe një herë ato vite të hidhura, që të gjithë ne së bashku nuk do të donim të përsëriteshin. Mbulesa e Kokës e grave muslimane duhet patjetër të deklasifikohet si simbol fetar, gjithashtu edhe mjekrat (sepse do të na duhej të vendosnim një berber në hyrje të shkollës, ashtu siç qëndronte në regjimin monist në hyrje të aeroportit). Kjo gjë duhet vendosur pranë pikës 36/4 për të mos lënë shteg për keqkuptime, si dhe për të thelluar më tej nivelin e demokratizimit të jetesës sonë edhe për të arritur standardet evropiane për të cilat qeverisja jonë demokratike ka vite që aspiron dhe po punon.

Deshëm t'u sillnim në vëmendje të nderuar drejtues, se kontributi i hoxhallarëve tanë për arsimin kombëtar është i hershëm dhe mund të përmendim këtu Mulla Daut Boriçin patriot dhe rilindës, autor i një abetareje shqipe, Hoxhë Vokën (Said Najdeni) pionier i arsimit shqip në Dibër e rrethina, Hafiz Ali Korça i cili rrëmbeu armët e luftoi "për të bërë Shqipërinë" me abetaren e të cilit kanë mësuar shumë njerëz shqipen gjatë Luftës I Botërore, Hafiz Ibrahim Dalliu opozitarin e përjetshëm, dijetarin e shquar mysliman, i cili e shkriu jetën e vet për

Shqipërinë dhe përparimin e saj, një nga mësuesit dhe mbështetësit e Normales së Elbasanit, ku u hodhën edhe bazat e arsimit kombëtar shqiptar, të cilat u rrezatuan në të katër anët e trojeve shqiptare. E lista mund të vazhdojë e gjatë. Çfarë do të thonin këta mësues të ndritur sikur ta dinin që femrën shqiptare do ta persekutojnë pikërisht në këto ditë, për të cilat ata luftuan dhe aspiruan?!...

Ju kujtojmë këtu vargjet e rilindësit dhe patriotit Hafiz Ali Korçës:

“Për Shqipërinë u përpoqa

Rrezikova jetën t’ime,

Nuk rrëfehët se sa hoqa

Se shteti m’i njihte krime.”

Së fundi ju sjellim në kujtesë deklarin e presidentit Barak Obama në fjalimin e mbajtur prej tij në Universitetin e Al-Az’harit në Kajro më 4 qershor 2009: “Gjithashtu, liria në Amerikë është e pandashme nga liria për të ushtruar fenë. Për këtë arsye ka xhami në çdo shtet të bashkësisë sonë, dhe mbi 1,200 xhami brenda kufijve tanë. Për këtë arsye qeveria e Shteteve të Bashkuara ka shkuar në gjykatë për të mbrojtur të drejtat e grave dhe vajzave për ta mbajtur hijabin (shaminë) dhe t’i dënojë ata që do ta mohojnë këtë. (ref. http://photos.state.gov/libraries/kosovo/821/albanian_pdf/speechincairoalbanian.pdf)

Forumi Musliman i Shqipërisë shprehet se do të gjejë mirëkuptimin Tuaj dhe se sugjerimet tona do të merren parasysh, në mënyrë që kjo çështje të gjejë menjëherë një zgjidhje përfundimtare. Mendojmë se i duhet dhënë fund kategorizimit dhe klasifikimit të Mbulesës së Kokës (dhe jo të fytyrës) si një simbol fetar, i cili pengon laicitetin e shkollës.

Me respekt:

Kryetari/ Fisnik Kruja



Kontakti: Rr, Sami Frasheri, p. 20/3, ap. 1 Tiranë, Albania e-mail: info@fmsh-al.org web: www.fmsh-al.org cel: 067 20 72 291